REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9848/5 Prot.

Lezhë, më 26. 06. 2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në datën 26.06.2026, në orën 11:00, në Bibliotekën "Gjergj Fishta" Lezhë, mbi dëgjesën publike në lidhje me projekt vendimin "Për miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohen rishtaz në pronësi të Bashkisë Lezhë të Qarkut Lezhë".

I pranishëm është këshilltari Zek Doda.

Takimi u hap nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ndue Luli.

-Ndue Luli: Siç jeni në dijeni, jemi mbledhur sot për një dëgjesë publike në lidhje me projekt vendimin "Për miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohen rishtaz në pronësi të Bashkisë Lezhë të Qarkut Lezhë", të paraqitur në këshillin bashkiak.
Bëhet fjalë për varrezat që ndodhen në lagjen "Nënë Tereza", të cilat ka pothuajse 30 vite që ka nisur, por që gjatë këtyre viteve nuk është bërë asnjë hap që të kalojnë në pronësi të bashkisë. Kuptohet, që duke i kaluar bashkisë, shërbimet do të jenë më të mira për komunitetin.
Për sqarime të mëtejshme është prezent drejtori i Aseteve z. Nikolin Shtjefni.

-Nikolin Shtjefni: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit që jeni prezent. Siç e dini, sidomos pjesa e banorëve që jetojnë në atë lagje, kjo çështje është një problematikë prej më shumë se 30 vitesh. Aty është bërë një katrahurë mund të them, pasi vendosja e tyre është në mënyrë informale, jo të rregullt. Për këtë arsye është parë e nevojshme që ne të regjistrojmë pronën, është një punë që ka nisë prej më shumë se një viti sepse vetë procedura është e tillë. Kemi shkuar e kemi bërë matjet në terren dhe kemi përjashtu ato hapësira të cilat janë të zëna nga privati, që kanë banesa, që nesër pasnesër mos të kemi konflikte me banorët e zonës. Jemi zgjeruar në ato zona që është parë e arsyeshme që mund të zgjerohemi, duke pasë perspektivë, se varrezat kërkojnë hapësira, njerëzit ndërrojnë jetë.
Ne kemi bërë gjithë procedurën për regjistrimin e kësaj hapësire. Normalisht kërkon bashkëpunimin edhe të ASHK-së, edhe vendore, edhe qendrore. Është një procedurë që momentalisht ndodhet në këshill për vendimmarrje, që ne të çojmë më përpara këtë procedurë. Normalisht, që bashkia të jetë prezent me investimet e saj, pra të vërë rregull, duhet të jetë pronare e asaj sipërfaqeje. Dhe ne jemi pikërisht te kjo pjesë, te pjesa që po kërkojmë ta fusim te lista e aseteve, pronave të bashkisë, në mënyrë që të parashikohen investimet e duhura për të bërë rrethimin, për të bërë sistemimin, për të dhënë dhe leje më vonë, se si do organizohet ajo varrezë, që të mos lihet në mëshirë të fatit siç është.

Nqs ka dikush një shqetësim ose një ide, jemi gati që të përgjigjemi.

-Ndue Luli: Sa për dijeni kemi dhe përfaqësues nga ASHK dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashki, kështu që secili mund të bëjë pyetje ose sugjerime.

-Gjergj Malshi, banor: S`ka pse të ketë shqetësim. Rëndësi ka që është tokë shtet dhe po ndiqen procedurat ligjore të argumentuara për ta bërë pronë të bashkisë, që ta administrojë bashkia e t`i shërbejë komunitetit. Nga eksperienca ime, se unë kam punuar në pushtetin vendor, çështja e varrezave është një problem shumë i madh.

-Nikolin Shtjefni: Fakti që ne jemi këtu është se është pjesë e procedurës, që ne ta legjitimojmë.

-Emirjan Zefi, Agjenci funerale: Unë ju përgëzoj për nismën që keni marrë. Unë ka rreth 12 vite që jam pjesë e kësaj fushe. Varrezat e Lezhës janë për t`u marrë model për keq. Është një sektor që gjithë republika ka një lloj modeli rreth kësaj. Duhet të zbatohet ligji tamam, pra të hiqen gjithë ato gardhiqet, jo vetëm në ato varreza por do Zoti edhe në varrezat e tjera, që të kthehen në normalitet, se vetëm në normalitet nuk janë për momentin.

-Nikolin Shtjefni: Kjo është dhe arsyeja pse ne po e bëjmë këtë punë, që tëë fillojmë t`i legjitimojmë sepse janë bërë si puna e ndërtimeve pa leje.
Normalisht është kohë e gjatë që kanë funksionuar në atë mënyrë, rreth 30 vjet, por të paktën të fillojmë të sistemojmë dhe të orientojmë drejt për pjesën e hapësirës që është bosh.

-Emirjan Zefi, Agjenci funerale: Çdo hapje varri të jetë e orientuar nga bashkia, mos të vazhdojë sipas qejfit prapë.

-Nikolin Shtjefni: Ne e bëjmë në momentin që ne jemi pronarë të asaj sipërfaqeje.

-Gjergj Malshi, banor: Kur nuk janë pronë e bashkisë, fenomeni më negativ është që njerëzit shkojnë tu shit varre se është prona ime, e kanë zaptuar tokën dhe ky është fenomen që ndodh rëndom, kështu që kjo është një nismë e jashtëzakonshme që duhet të përparojë në çdo fshat, në çdo zonë.

-Ndue Luli: Kush ka ndonjë gjë tjetër?

-Banor i fshatit Rrilë: Unë jam një banor i fshatit Rrilë dhe dje varrosëm një komshi dhe 5 mln lekë e ka blerë tokën e varrit te varrezat e Pyllës.

-Artur Pjetri, Drejtoria e Aseteve: Problemi me pronat e ish komunave, Lezha dhe Dajçi janë me VKM, njësitë e tjera administrative kanë kalu 2 faza dhe bëhet shpallja 45 ditore dhe nëse nuk ka pretendime kalohet për VKM për fazën e tretë. Këto ish komuna nuk e kanë ba. Në vitin 2015 ndryshooi ligji dhe u bënë bashkitë e mëdha.

Tani që është bërë VKM e fundit, në vitin 2020, marr informacion dhe thotë: nuk është brenda parcelës. Ndërkohë që në kohën e komunave kanë qenë me VKM. Tani duhet të përditësohen se mund të jetë legalizuar një shtëpi, etj, duhet të hien të gjitha dhe të regjistrohet vetëm prona shtet. Kjo procedurë është shumë voluminoze.

-Ndue Luli: Në mbledhjen e këshillit do ta ngremë problematikën e varrezave të njësive administrative.
Një gjë dua të sqaroj në lidhje me marrjen në konsideratë të varrezave të lagjes "Nënë Tereza", ka të paktën 2 vjet që kërkesa me shkrim nga banorët e lagjes kanë ardhur në bashki e në këshill në lidhje me këtë shqetësim dhe është një procedurë tepër e gjatë për të ardhur te kjo pikë, se duhej bërë kjo harta e cila ka të gjitha konturet dhe kur të merret vendimi në këshillin bashkiak, nuk mund të futet kushdo brenda këtyre kontureve.
Ka mendim tjetër?

-Pjeter Gjoka, Banor: Falenderime për nismën që është fillu. Mendoj se duhet të angazhohet urbanistika me një studim aty për rregullimin e asaj që është dhe çfarë mund të bëhet. Unë e falenderoj këshillin. Nuk është vonë për çfarë mund të shpëtohet. Atje është kaos. E dimë të gjithë. S`ke nga lëviz. Jam plotësisht dakord. Të ketë mirëadministrim.

-Ndue Luli: Ka dikush tjetër ndonjë diskutim?

-Fatmir Dushi: Unë jam pronar pike mermeri në zonën pranë. Ka problematikë me mbeturinat në rrugën e varrezave.

-Nikolin Shtjefni: Prandaj po e bëjmë këtë gjë, në mënyrë që të administrohet nga bashkia çdo problematikë që ndodh.

-Ndue Luli: Meqë është tokë e shtetit, ne sot jemi mbledhë që këtë tokë ta marrë bashkia dhe ta administrojë bashkia. Duke e administruar bashkia, do të thotë që të rrethohet, të shikohen rrugët, të përcaktohet se ku do të hapet varri. Për këtë merret vendim në mbledhjen e ardhshme të këshillit. Pas mbledhjes së këshillit, bashkia ka të drejtën e vet për t`u marrë me problematikën e varrezave.

-Nikolin Shtjefni: Të bëj edhe një sqarim sepse shpesh herë ngatërrohet kjo pjesa, toka është e bashkisë. Gjithmonë kur regjistrohet një pronë, si fillim regjistrohet si pronë e shtetit, dmth bashkia është ent më vete, dhe kalon me VKM dhe atëherë bëhet pronë e bashkisë. Si fillim ne do ta regjistrojmë si pronë shtet se është totalisht e paregjistruar, nuk ka një numër pasurie, nuk ka një kartelë, nuk ka një hartë. Kjo është puna fillestare që ne po bëjmë.

-Fatmir Dushi: Kurdo që të bëhet ndërhyrje, të shikohet pak aty te hyrja e biznesit se e kanë ngushtuar dhe sa herë bëhen varrime, i parkojnë aty makinat dhe ma bllokojnë krejt hyrjen e biznesit dhe s`mund të flas se është rast....

-Nikolin Shtjefni: Kjo është dëgjesa e parë që ne po bëjmë për këtë rast dhe mbas regjistrimit do ketë edhe dëgjesa të tjera dhe në momentin që do ketë një investim dhe që do bëhet dëgjesë, ju ftoj të gjithëve të jeni prezent sepse është shumë e rëndësishme dhe ju t`i trajtoni ato hallet që keni aty, në mënyrë që të merren parasysh.

-Emirjan Zefi, Agjenci funerale: Duke qenë se jam i fushës, është një vendim që është marrë në shtator, ka hy në fuqi në 30 mars, për sa i përket shtëpive funerale dhe këtu kemi në lidhje me licencat nga drejtoria e shërbimeve. Kur e ka miratu këshilli bashkiak, ka kërku morg, ka kërku 6 punëtorë, ka kërku pozicionim të shtëpive funerale në zona të caktume dhe unë jam mundu me i zbatu . Ndërsa te licenca, morgu hiqet si opsion dhe kalon si opsion që ti mund ta bësh edhe te morgu i shtetit. Atëherë mu pse më bane me ba shpenzime, edhe 6 punëtorë që m`ke ba me i regjistru dhe po i paguj, është edhe pjesa që janë godina që kanë apartamente për banim dhe këtu e kanë kalu në aktivitet me njësi banimi, që është diçka tjetër nga ajo që është shkrujt këtu, pra ka një tjetërsim nga vendimi i këshillit bashkiak

-Ndue Luli: Emirjan, jam në dijeni të kërkesës tënde në mënyrë verbale. Të bësh një kërkesë me shkrim me të gjitha pikat që e shikon ti që janë në kundërshtim me atë rregullore të miratuar në këshillin bashkiak. Kërkesën t`ia bësh kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak që të marrësh përgjigje në mënyrë zyrtare.
Ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI